TÜRK HAVA YOLLARI A.Ö., një kompani që ekziston sipas ligjeve të Turqisë, me adresën e saj të regjistruar në Genel Yönetim Binasi, Yeşilköy Mah. Havaalanı Cad. Nr: 3/1 34149 Bakırköy, Stamboll, Turqi, me numër regjistrimi 75184 në dhomën e tregtisë Stamboll në vijim referuar si **Turkish Airlines**; dhe

MDN Investment SHPK një kompani e regjistruar dhe që operon në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me adresën e saj të regjistruar në Lagjen "Pavarësia", Rajoni nr.2, Pallati "Haxhari dhe Breshani", Kati i II-të, Bulevardi "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri dhe NIPT nr. L86707201P, në vijim referuar si **MDN**;

Turkish Airlines, Albcontrol dhe MDN janë referuar individualisht si "Palë" dhe të referuara së bashku si "Palët";

Ku Palët dëshirojnë të themelojnë së bashku një sipërmarrje të përbashkët si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri për transportin ajror dhe shërbime të tjera të dakortësuara reciprokisht, në vijim e referuar si "SHOQËRIA" apo "AIR ALBANIA"; dhe

Këtu e në vijim, duke pasur parasysh premisat dhe kushtet reciproke, dispozitat dhe detyrimet që përmbahen këtu, si dhe konsiderata të tjera të mira dhe të vlefshme, evidenca dhe mjaftueshmëria e të cilave është e njohur këtu, Palët bien dakord si më poshtë:

**Kreu I
Përkufizime dhe baza ligjore**

**Neni 1
Përkufizime**

"Data e themelimit" nënkupton datën e regjistrimit të Shoqërisë, më saktësisht të përcaktuar në Nenin 4;



"Asambleja e Përgjithshme" ose "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" nënkupton organin më të lartë në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila përbëhet nga partnerët, siç përcaktohet nga ligji tregtar;

"Ndryshim i Kontrollit" nënkupton në lidhje me një Shoqëri:

- (i) Bashkim, konsolidim, likuidimin ose riorganizim i një Shoqërie në një ose me një tjetër Shoqëri ose person juridik, pas së cilës bashkimi, konsolidimi, likuidimi ose riorganizimi i kapitalit të mbetur para këtij transaksioni të Shoqërisë nuk është konvertuar ose këmbyer ose nuk përfaqëson më tepër se 50% të tërësisë së votave të Shoqërisë së mbijetuar ose të Shoqërisë që ka rezultuar;
- (ii) Përvetësimin direkt ose indirekt nga ndonjë person që zotëron më shumë se 49% të aksioneve me të drejtë vote në një Shoqëri, në një ose më shumë transaksione; ose
- (iii) Shitja, këmbimi ose transferimi i njësisë tregtare ose divizionit, i cili mbështet AIR ALBANIA ose obligimet e një Pale sipas kësaj Marrëveshje; ose
- (iv) Shitja, këmbimi ose transferimi i të gjitha ose në thelb të gjitha asetet e një Shoqërie (të tjera nga shitja, këmbimi ose transferimi në një ose më shumë Shoqëri ku ortakët e Shoqërisë menjëherë para një blerje të tillë, këmbimi ose transferimi mbajnë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose indirekte, të paktën një maxhoritet të interesit përfitues në aksionin votues të Shoqërisë ku u transferuan asetet).

Neni 2 Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, kryesisht, por jo vetëm në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar); ligjin nr.10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile" (i ndryshuar); ligjin nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar); ligjin nr.9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" (i ndryshuar); ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 "Mbi investimet e huaja"; ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt" (i ndryshuar); ligjin nr. 7607, datë 15.09.1992 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr.274, datë 16.05.2018 "Për kalimin në pronësi nga shoqëria Aeroporti "Nënë Tereza"SHA, Tiranë të shoqëria "ALBCONTROL" SHA, Tiranë, të dy pasurive"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr.309, datë 16.05.2018 "Për përcaktimin e procedurave të krijimit të shoqërisë "AIR ALBANIA"; udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr.17, datë 02.09.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore" (i ndryshuar).

**Kreu II****SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR****Neni 3****Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të operojë në lushën e transportit ajror, ku organizimi, funksionimi, regjistrimi dhe licencimi i së cilës do të bëhet në zbatim të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, si dhe palët do të ndajnë fitimin, humbjen dhe rrezikun sipas përqindjeve përkatëse të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Neni 4**Data e themelimit**

Data e themelimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë data në të cilën Shoqëria do të jetë regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5**Emri dhe adresa**

1. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë "AIR ALBANIA" SHPK.
Zyra qendrore/selija e shoqërisë do të jetë në adresën: "Rruga e Durrësit", Nr. 202, Tiranë, Shqipëri. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, AIR ALBANIA mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra, degë, filiale, apo të krijojë kompani të lidhura brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, mbështetur në legjislacionin përkatës.

Neni 6**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e AIR ALBANIA do të jetë për një afat të pacaktuar.

Neni 7**Pajtueshmëria me ligjin**

1. Palët bien dakord që:
 - a. Ngritja dhe funksionimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar AIR ALBANIA duhet të përputhet me: (i) legjislacionin shqiptar të zbatueshëm parashikuar në neni 2, (ii) termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.



- b. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar AIR ALBANIA gëzon të drejtën për të përfutuar nga dizpozitat përkatëse të ligjeve, rregullave, dekreteve të Republikës së Shqipërisë, që janë të zbatueshme për sipërmarrjet me investime të huaja, duke përfshirë po jo kufizuar në ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Mbi investimet e huaja”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 7607, datë 15.09.1992 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve”.
- c. Turkish Airlines, në përmbushje të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshje, përveç zbatimit të legjisllacionit shqiptar, do të jetë subjekt edhe i zbatimit të legjisllacionit, rregulloreve, dekreteve dhe rregullave në fuqi të Republikës së Turqisë.
- d. Nëse pas datës së ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, legjisllacioni shqiptar, qoftë në nivel kombëtar ose lokal, ofron trajtime për sipërmarrjet me investim të huaj të cilat janë më të favorshme se kushtet e parashikuara nga kjo Marrëveshje në ndonjë ligj, rregullore, dekret tjetër (duke përfshirë, pa kufizim, urdhërat, ligjet, rregulloret, dekretet, rregullat, Vendime të Këshillit të Ministrave ose Vendime Gjyqësore të Unifikuara), atëherë palët në këtë Marrëveshje do të (nëse është e nevojshme) përdorin përpjekjet e tyre më të mira për të siguruar që shoqëria AIR ALBANIA të përfutojë nga trajtime të tilla, me kusht që interesat e secilës Palë të mos ndikohen negativisht në të.

Kreu III VEPRIMTARIA

Neni 8 Veprimtaria

Shoqëria do të hazohet dhe veprojë mbi bazën e parimeve më të mira dhe të ligjshme të biznesit, duke ofruar shërbime me qëllim sigurimin e fitimit në nivele të pranueshme për shoqërinë. Shoqëria do të krijojë dhe mbajë standardin e veprimtarisë dhe menaxhimit të saj, si dhe do të përpiqet të sigurojë rezultate të dobishme ekonomike për të përmbushur veprimtarinë e saj në mënyrë që të sigurojë dhe të risë konkurrencën në aspektet e efikasitetit, cilësisë, çmimit dhe orarit të shërbimit.

Neni 9 Objekti

Shoqëria do të kryejë të gjitha llojet e transportit ajror të brendshëm dhe ndërkombëtar, duke përfshirë të gjitha llojet e transportit ajror për pasagjerët, postën, kafshët dhe ngarkesën për në dhe nga çdo pikë brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe të gjitha punët dhe angazhimet e tjera të rastit lidhur me to, duke përfshirë por jo kufizuar në shërbimin e furnizimit me ushqim, shërbimet në tokë (ground handling) dhe shërbimet në sallat e pritjeve (lounge services), si dhe operacione tregtare të avionëve / riparimin dhe mirëmbajtjen e avionëve.



Kreu IV KAPITALI

Neni 10

Kapitali dhe shpërndarja e fitimeve

1. Shoqëria do të krijohet me një kapital fillestar prej 100,000 (njëqind mijë) lekë. Palët do të nënshkruajnë për pagesën e kapitalit fillestar, sipas përqindjeve përkatëse të ofruara. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara në 3 (tre) kuota si më poshtë:
 - a. **ALBCONTROL SHA** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 10% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë në kapitalin themeltar;
 - b. **MDN Investment SHPK** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 41% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë në kapitalin themeltar;
 - c. **Turkish Airline** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 49% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë në kapitalin themeltar;
2. Ortakët shlyejnë plotësisht kapitalin e nënshkruar në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.
3. Shoqëria shpërndan dividendë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat e nenëve nga 76 në 79 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
4. Palët bien dakord të financojnë shoqërinë në propocion me përqindjet takuese një vlerë totale prej 200.000 (dyqindmijë) USD (e barazvlefshme në monedhën shqiptare lekë) brenda 5 (pesë) ditëve nga data e themelimit, për të mbuluar kostot e operimit të Shoqërisë. Për të shmangur keqkuptimet, AIR ALBANIA nuk do të fillojë fluturimet deri në hyrjen në fuqi të dokumentave të referuara në Nenin 27.2 të kësaj Marrëveshje.

Neni 11

Kushtet për zotërimin dhe tjetërsimin e kuotave

1. Në përmbushje të kërkesave detyruese të akteve ligjore, ALBCONTROL, së bashku me MDN, duhet të zotërojnë jo më pak se 51% të kuotave të AIR ALBANIA.
2. E drejta e tjetërsimit të kuotave nuk mund të çënojë kushtin e kontrollit efektiv dhe të zotërimit të jo më pak se 51% të kuotave të kësaj shoqërie nga subjekti shtetëror shqiptar vetëm apo së bashku me subjekt tjetër privat shqiptar.
3. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë marrëveshje, secila prej palëve nuk mund të transferojë kuota brenda një afat kohor prej 5 (pesë) vjetësh nga data e themelimit. Me kalimin e këtij afati, çdo transferim i kuotave do të bëhet me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme me shumicë të ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se 55% të kuotave të shoqërisë.
4. Pala MDN, çdo ndryshim i kontrollit në MDN, do të jetë subjekt i aprovimit paraprak në Asamblesë e Përgjithshme, me një shumicë të 55 të kuotave të Shoqërisë. Ortakët e MDN do të japin aprovimet e nevojshme dhe do të bëjnë ndryshimet e kërkuara të dokumentave



- themeltare, për të reflektuar detyrimet e përmendura në këtë nen, nuk mund të ushtrojë të drejtën e tjetërsimit të kuotave të veta të zotëruara në kapitalin e MDN-së, të palët treta, në një vlerë prej 51% të kuotës/kuotave të MDN pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Secili prej ortakëve mund të ushtrojë të drejtën e shitjes së kuotave tek palët e treta, pas kalimit të afatit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, vetëm pasi ortaku shitës i ka ofruar për shitje kuotat ortakëve të tjerë, të cilët gëzojnë të drejtën e parablerjes, gjithmonë pa cënuar kushtin e parashikuar në pikën 1 dhe 2 të këtij neni. E drejta e parablerjes dhe kufizime të tjera të kuotave do të detajohen në dokumentat e referuar në nenin 27.2.
 6. Kuotat nuk mund t'i ofrohen për shitje palëve të treta me çmim më të ulët se ai i ofruar ortakëve.

Kreu V ORGANET E SHOQËRISË

Neni 12 Organet e Shoqërisë

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
 - Asambleja e përgjithshme;
 - Administratori.
2. Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në nenet në vijim.

Neni 13 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i shoqërisë dhe është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtëme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) miratimi i statutit dhe ndryshime të tij;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
- l) strukturën e shoqërisë dhe numrin e punonjësve;
- m) kufijtë dhe nivelin e pagave për pozicion në shoqërinë AIR ALBANIA;
- n) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Një ortak mund të marrë pjesë në Asamblesë e Përgjithshme nëpërmjet tele – konferencës, video – konferencës ose forma të ngjashme të pajisjeve të komunikimit, të cilat lejojnë të gjithë personat pjesëmarrës në mbledhje, të dëgjojnë dhe të flasin me njëri – tjetrin gjatë gjithë mbledhjes. Një ortak që merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet si të jetë prezent personalisht në mbledhje dhe llogaritet në kuorum dhe ka të drejtë vote.

Neni 15

Thirja e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi, Vendimmarrja në Asamblesë e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe i dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime.
3. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo më pak se 60 % të kuotave. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të sigurojë shumicën e parashikuar në këtë pikë, atëherë Asambleja do të thirret sërish jo më vonë se 30 ditë, më të njëjtën rëndësi dhe do të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët që zotërojnë jo më pak se 55% të kuotave të shoqërisë.
4. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 60% të kuotave, janë të pranishëm. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në këtë pikë, asambleja mbledhet



përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite vetëm nëse ortakët pjesëmarrës zotërojnë jo më pak se 55% të kuotave .

5. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve që zotërojnë këtë përqindje kuotash (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, por në çdo rast, miratimi i këtyre vendimeve kërkohet me 55% të të gjithë kuotave . Për çështjet e tjera të renditura në nenin 13 të kësaj marrëveshje, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve që zotërojnë 55% të kuotave.
6. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në procesverbal, i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, pjesëmarrësit në mbledhje, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Neni 16

Administratori

Administratori i shoqërisë emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në propozimin e paraqitur nga Turkish Airlines. Afati i emërimit është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhje. Ortakët e tjerë do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në Asamblesë e Përgjithshme, duke siguruar që Administratori është emëruar në përputhje me këtë parashikim.

Administrator i shoqërisë është z. Sinan Dilek, pajisur me dokument identifikimi pasaportë nr. U02717349.

Neni 17

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë sipas përcaktimeve të Statutit dhe legjislacionit në fuqi.
2. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
 - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të drejtojë shoqërinë, të marrë vendime, si dhe të japë direktiva për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare të miratuara nga Asambleja;
 - c) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - d) të sigurojë mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - e) të sigurojë përgatitjen dhe të nënshkruajë planbiznesin strategjik, planbiznesin vjetor, bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat i paraqet për miratim në Asamblesë e Përgjithshme;
 - f) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;



- g) të kryej regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo të ligjeve të tjera;
 - h) të përcaktojë politikat dhe objektivat e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve, si dhe të sigurojë ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe cilësisë;
 - i) të propozojë strukturën organizative të shoqërisë dhe ta kalojë për miratim në Asamblesë e Përgjithshme
 - j) të nxjerrë akte me karakter normativ (urdhura) me qëllim përmbushjen e funksioneve të njohura nga ligji dhe statuti i shoqërisë;
 - k) të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë pa të drejtë vote;
 - l) të emërojë dhe të shkarkojë nga detyra punonjësit e shoqërisë, si dhe të japë masa administrative ndaj tyre sipas përcaktimeve të Kodit të Punës;
 - m) të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një auditues ligjor i autorizuar i pavarur;
 - n) të autorizojë të drejtën e kryerjes së veprimeve të veçanta apo kategori veprimesh të një ose disa punonjës të shoqërisë;
 - nj) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë;
 - o) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në Statut.
3. Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve duhet të nënshkruhen nga administratori ose personi i autorizuar prej tij. Në rastet kur këto akte tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë apo kompetencat e saj, si dhe kur veprohet në keqbesim, këto akte janë të pavlefshme.
4. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi kompetencat dhe detyrat e Administratorit, duke përfshirë dhe kufizime. Asambleja e Përgjithshme ose dokumentat e referuara në nenin 27.2, mund të krijojnë dhe t'i japin kompetenca një strukture tjetër menaxheriale, në lidhje me menaxhimin e AIR ALBANIA.

Kreu VI

TË DREJTA DHE DETYRIMET E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

Neni 18

Institucionet Përgjegjëse

1. Në zbatim dhe kuptim të kësaj Kontrate, përveç Palëve kontraktuese, pjesë e rëndësishme janë edhe Institucionet përgjegjëse të cilat licencojnë, kontrollojnë dhe auditojnë veprimtarinë e shoqërisë duke siguruar funksionimin e saj.
2. Institucionet kryesore përgjegjëse janë:
Autoriteti i Aviacionit Civil. Autoriteti i Aviacionit Civil është institucioni përgjegjës për të monitoruar shërbimet që ofrohen nga shoqëria AIR ALBANIA. Autoriteti në cilësinë e



autoritetit kombëtar të mbikëqyrjes në fushën e Aviacionit Civil si dhe në përputhje me detyrimet e parashikuara nga Kodi Ajror ka përgjegjësinë për:

- a) Licencimin e certifikimit shoqërisë, ku përfshihet:
 - i) Licencë operimi;
 - ii) Certifikata e operatorit ajror.
- b) licencimin dhe certifikimin e avionëve që do të përdoren nga Shoqëria, përfshirë inspektimet e nevojshme të kushteve teknike dhe operacionale të avionit:
 - i) Licencë trafiku;
 - ii) Certifikatë tipi;
 - iii) Certifikatë të vlefshmërisë ajrore;
 - iv) Certifikatë të lejitimit për shërbim.
- c) licencimin dhe klasifikimin e pilotëve, të anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit dhe personelit tjetër të avionit, që duhet licencuar sipas Kodit Ajror, përfshirë licencimin e instruktorëve të fluturimit për këtë personel;
- d) mbledhjen e informacionit për personelin dhe avionët, si dhe për shpërndarjen e tyre;
- dh) mbledhjen dhe analizimin e raporteve dhe të dokumenteve të tjera për teknologjinë, operimin e avionëve si dhe personelin e shoqërisë;
- e) auditimin e kushteve teknike dhe operuese, si dhe të fuqisë ekonomike të Shoqërisë dhe sistemeve trajnuese të aviacionit;
- ë) bashkërendimin, certifikimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë;
- f) monitorimin e çmimeve dhe tarifave, të aplikuara nga shoqëria, si dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e tarifave dhe praktikave diskriminuese apo çmimeve abuzivisht të larta si dhe çmimeve abuzivisht të ulëta.

Organi Kombëtar për Investigimin e Aksidenteve dhe Incidenteve (OKIAI). OKIAI ka detyrimin të kryejë investigimin e aksidenteve dhe incidenteve të rënda. Ai ka autoritet të pakufizuar për zhvillimin e investigimit duke investiguar aksidente apo incidente serioze, që mund të përfshijnë avionët në pronësi dhe/ose përdorim nga ana e shoqërisë. Kur aksidenti apo incidenti ka ndodhur jashtë territorit shqiptar, OKIAI do të investigojë, për aq kohë sa helime të tilla nuk do të kryhen nga një shtet tjetër.

Aeroporti "Nënë Tereza", në cilësinë e aeroportit të vetëm të licencuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje administron, operon dhe mirëmban të gjithë anën ajrore dhe infrastrukturën, duke përfshirë lëvizjet në tokë dhe shërbimet e lidhura për operimet në lidhje me mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve civilë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në cilësinë e autoritetit përgjegjës për regjistrimin e markave dhe shërbimeve do të ekzaminojë kërkesën e ALBCONTROL për regjistrimin e AIR ALBANIA si markë. Nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat për regjistrimin e një marke, DPPI-ja do të vijojë procedurat ligjore deri regjistrimin në regjistrin e markave dhe do të lëshojë certifikatën e regjistrimit.

3. Institucionet përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve në lidhje me këtë marrëveshje, udhëhiqen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare, si edhe aktet ligjore e nënligjore të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 19****Sanksionet në rast mospërbushje të detyrimeve**

Palët e kësaj marrëveshje janë të vetëdijshme dhe bien dakort që në rast mospërbushje të detyrimeve të shoqërisë të parashikuara në legjislacionin shqiptar në fushën e transportit, janë subjekt i sanksioneve të aplikuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Kreu VII**PARIMET KOMERCIALE DHE FINANCIARE****Neni 20****Parimet komerciale dhe financiare**

1. Parimet komerciale të kësaj shoqërie do të bazohen në praktikat më të mira ndërkombëtare.
2. Parimet financiare të kësaj shoqërie do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar (SNRF/IFRS).

Kreu VIII**PUNËSIMI DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE****Neni 21****Punësimi**

1. Palët bien dakort që Shoqëria të ndjekë një politikë transparente, të drejtë dhe të paanshme të rekrutimit dhe punësimit të punonjësve, bazuar në kualifikimet, aftësitë individuale dhe eksperiencën e mëparshme në punë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe praktikat e mira në këtë fushë.
2. Rekrutimi, punësimi, transferimi, shkarkimi, dorëheqja, sigurimi në punë, shëndeti në punë, disiplina në punë dhe çështje të tjera që lidhen me punonjësit e AIR ALBANIA do të trajtohen në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të punës dhe ligje e rregulla të tjera që lidhen me të dhe që janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.
3. Politikat e punësimit do të synojnë interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi dhe interesat individuale të të punësuarve, në mënyrë të veçantë.
4. AIR ALBANIA do të sigurojë lidhjen e kontratave të punës me të gjithë punonjësit e saj, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Kontrata do të nënshkruhen edhe për të gjitha shërbimet që do t'i ofrohen shoqërisë, për aq sa është e detyrueshme. Kontratat individuale të punës do të



ndëhiqet nga interesi më i mirë i AIR ALBANIA dhe individit të punësuar.

5. Punësimi i të huajve në shoqërinë AIR ALBANIA do të jetë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.
6. Ndryshimet në kontratën e punës duhet të bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga i punësuari dhe AIR ALBANIA.

Neni 22

Trajnimet e stafit

AIR ALBANIA merr të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë cilësi në ofrimin e shërbimit në zbatim të legjislacionit përkatës dhe/ose në interesin më të mirë të Shoqërisë, nëpërmjet trajnimeve të personelit brenda dhe jashtë vendit, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Neni 23

Detyrimi mbi konfidencialitetin e punonjësve të Shoqërisë

Kontratat individuale të punës së AIR ALBANIA do të përmbajnë dispozitë të posaçme mbi detyrimin e punonjësve të saj për zbatimin e rregullave të konfidencialitetit dhe pronësisë intelektuale, sipas përcaktimeve ligjore.

Neni 24

Përgjegjësia sociale

Përgjegjësia sociale e shoqërisë do të jetë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe subjekt i vendimmarjes së Asmblesë së Përgjithshme.

Kreu IX

FORCA MADHORE

Neni 25

Forca Madhore

Rrethanat e forcës madhore do të detajohen në dokumentat e referuara në nenin 27.2 .



Kreu X
RREGULLIMI I SHKELJEVE

Neni 26
Rregullimi i shkeljeve

1. Përveç të drejtave të tjera që mund të kenë Ortakët (Pala në Mospërbushje), me ndodhjen e një Rasti të Mospërbushjes (i përcaktuar në vijim), Pala në Mospërbushje mund të aplikojë parashikimet e nenit 26.2, siç është parashikuar aty, "Rast i Mospërbushjes" do të konsiderohet të ketë ndodhur, duke përfshirë por jo kufizuar, nëse njëra Palë (Pala në Mospërbushje):
 - (a) Dështon të përformojë ndonjë kusht material ose kusht të kësaj marrëveshje dhe një dështim i tillë vazhdon për 10 (dhjetë) ditë, pasi është dhënë njoftimi me shkrim për këtë dështim tek Pala në Mospërbushje;
 - (b) Është objekt i një ngjarjeje të paafëzisë paguese; ose
 - (c) Kryen një transferim të kuotave në kundërshtim me këtë Marrëveshje;
 - (d) Dështon të miratojë dokumentat e referuara në nenin 27.2, në përputhje me këtë Marrëveshje, përveç rasteve të dakordësuara ndryshe nga të gjitha Palët.
2. Nëse Rasti i Mospërbushjes egziston dhe vazhdon për një periudhë me të gjatë se 10 ditë, siç është përcaktuar në nenin 26.1 për Palën Përbushëse, çdo Palë në Mospërbushje, pa kufizur në të drejtën për dëmshpërblim të dëmit të shkaktuar, ka të drejtën të kërkojë tek ortakët e tjerë për prishjen e Shoqërisë, përveç të drejtave të tjera të Palës në Mospërbushje. Ortakët e tjerë ushtrojnë të drejtën e votës së tyre në Asamblesë e Përgjithshme, në përputhje me këtë parashikim.

Neni 27
Kushtet dhe procedurat për ndryshimin/përfundimin e marrëveshjes

1. Kusht për ndryshimin/përfundimin e kësaj marrëveshje është vullneti i shprehur me shkrim i palëve sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj Marrëveshje.
2. Palët bien dakort që brenda 30 ditëve nga themelimi i shoqërisë, duhet të detajojnë dhe ndryshojnë këtë Marrëveshje, duke miratuar dy dokumenta të tjerë, përkatësisht Marrëveshjen e Ortakëve dhe Statutin, të cilat duhet të aprovohen me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Në rast se Këshilli i Ministrave nuk i miraton këto dy dokumenta brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të tyre, këto dokumenta hyjnë në fuqi automatikisht.
3. Palët mund të bien dakort me shkrim në unanimitet për zgjatjen e afateve të referuara në këtë Marrëveshje.



4. Në rast se MDN nuk përmbush detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshje dhe/ose kushtin për miratimin e dokumentave të referuara në paragrafin e dytë më sipër brenda 30 ditëve nga data e themelimit dhe përveç të drejtave të tjera që një ortak mund të ketë, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të zëvendësojë MDN me një ortak (e) të ri(nj) i (të) pranuar nga Turkish Airlines, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë më sipër, në mënyrë që të garantohet kushti ligjor i kontrollit efektiv të 51% të kuotave të kapitalit nga Shteti Shqiptar dhe/ose nga Kompania Private Shqiptare.
5. Palët, për ndryshimin/përfundimin e kësaj marrëveshje, do të njoftojnë me shkrim njëra tjetrën mbi objektin e ndryshimit/përfundimit të marrëveshjes.

Kreu XI ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 28 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1.

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë, nga një ose më shumë arbitra, të përcaktuar në përputhje me këto rregulla. Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjyka do të jetë Anglishtja.

Kreu XII SIGURIMI I DETYRUESHËM

Neni 29 Sigurimi

1. AIR ALBANIA, gjatë gjithë kohës së aktivitetit të saj, duhet të sigurojë dhe mbajë sigurim konkurrues në përputhje me përcaktimet e ligjit 10040 datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe ligjit nr.52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Kreu XIII TË NDRYSHME

Neni 30 Prevalenca e Marrëveshjes



1. Kjo Marrëveshje e lidhur ndërmjet ALBCONTROL, Turkish Airlines dhe MDN prewalon të gjitha diskutimet, korrespondencat, shënimet, memorandumet, negociatat dhe të gjitha marrëveshjet e tjera ndërmjet palëve të realizuara para nënshkrimit të saj.
2. Çdo çështje tjetër e cila nuk është rregulluar qartësisht nga kjo marrëveshje, do të rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 31
Të ndryshme

Nëse ndonjë term ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje përcaktohet si joligjore nga çdo gjykatë kompetente, pjesa tjetër e kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet joligjore dhe do të vazhdojë në fuqi, pavarësisht dispozitës ose dispozitave të përcaktuara si të paligjshme.

Neni 32
Kopje

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën Angleze dhe nënshkruhet në 6 (gjashitë) kopje origjinale në gjuhën Angleze, nga një për secilën palë nënshkruese dhe 3 (tre) kopje të tjera për institucionet përkatëse shtetërore.

“ALBCONTROL” SHA

Turkish Airline

MDN Investiment SHPK